



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 25 Akti

Nr. 21 Vendimi

Tiranë më 06.06.2018

V E N D I M

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Firdes Shuli
Suela Zhegu
Roland Ilia

Kryesuese
Relatore
Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Ina Serjanaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Z. Hans Kijlstra, në Tiranë, më datë 4 qershor 2018, ora 14:00, në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anila Leka, prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”:**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioneren Suela Zhegu, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, Znj. Anila Leka, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Anila Leka, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Subjekti i rivlerësimit Znj. Anila Leka, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidate për anëtare në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Relatore çështjes u zgjodh me short Znj. Alma Faskaj. Për arsye shëndetësore, Znj. Faskaj është larguar nga puna për një afat të pacaktuar dhe për këtë shkak, më datë 23 maj 2018, çështja u rishortua duke u zgjedhur komisionere Suela Zhegu si relatore e çështjes.

Me vendimin e datës 13.12.2017, trupa gjyquese ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtares Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar Z. Hans Kijlstra.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe 3) Prokuroria e Përgjithshme (PP).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

1. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Raporti me nr. *** prot., datë 09.11.2017, i përbërë nga 10 fletë, është dërguar nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Anila Leka.*”

PP-ja, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si edhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk u gjetën indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Trupa gjyquese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes më datë 18.04.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Znj. Anila Leka, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 25.05.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupës gjyquese, si dhe u lajmërua se ka të drejtë të paraqesë pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e përfituara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupës.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2017, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

BASHKËPUNIMI ME SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT

Znj. Anila Leka ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Anila Leka, është prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime Tiranë” sh.a. dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

I. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare përfshirë interesat privat për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

- 1. Apartament⁴**, me sipërfaqe 91.51 m², me vlerë 34.000 USD, i ndodhur në Tiranë, pasuria nr. ***, ZK nr. ***, Rr. “***”.

Për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar si burim: *shitjen e banesës prindërore, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.02.1997, si dhe kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të prindërve me të cilët bashkëjeton.*

⁴ Blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.06.2006.

Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit⁵

Trupa gjyquese, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë apartament.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

- 2. Apartament** nr. ***, me sipërfaqe 76 m², me vlerë 3.000.000 (tre milionë) lekë ndodhur në Golem, Kavajë, pasuria me nr. ***, ZK nr. **. Pjesa takuese 100%. Apartament i paregjistruar në hipotekë.

Për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar si burim: *kursimet vjetore të çdo viti (paga dhe shpërblime)*. Mënyra e fitimit të pasurisë: deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.04.2014.

Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit⁶

Nga kërkimi i bërë në ZVRPP, nuk është konfirmuar regjistrimi i kësaj pasurie, fakt i konfirmuar edhe nga subjekti i rivlerësimit. Nga regjistri noterial është konfirmuar veprimi noterial⁷ me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.04.2014.

Trupa gjyquese, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë apartament.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

3. Likuiditete të subjektit të rivlerësimit

- Bono thesari, në vlerë 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Pjesa takuese 100%, nga të cilat 2.000.000 (dy milionë) lekë, shumë e pandryshuar nga viti 2010 dhe 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, shumë e pandryshuar nga viti 2016.
- Gjendja *cash*, krijuar nga kursimet e pagës vjetore të çdo viti në funksionin e prokurores dhe interesat e bonove të thesarit. Vlera 11.500 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) dollarë. Pjesa takuese 100%.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 5.01.2018, drejtuar ZQRPP-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 26.01.2018, ZVRPP Tiranë ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie.

Me shkresën nr. *** prot., datë 18.01.2018, ZVRPP Librazhd ka konfirmuar transkriptimin e pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.01.2018, ZVRPP Kavajë.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 19.03.2018.

- Gjendje në llogarinë rrjedhëse të pagës, banka “Credins”, deri më datë 24.01.2017, krijuar nga kursimet e pagës vjetore dhe interesat e bonove të thesarit. Vlera 232.682.80 lekë (dyqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy lekë e tetëdhjetë qindarka). Pjesa takuese 100%.

Sa më sipër, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e likuiditeteve: *kursime (cash) të deklaruara ndër vite dhe interesat e bonove të thesarit.*

Komisioni ka hetuar lidhur me gjendjen e likuiditeteve për subjektin dhe personat e lidhur në llogaritë bankare në institucionet bankare dhe jobankare. Në të njëjtën kohë, subjekti është pyetur lidhur me kursimet *cash* nga pagat, nëse në to përfshihen gjendjet e bankave apo vetëm gjendja *cash* në shtëpi.

Subjekti ka deklaruar se:

“Prej vitit 2003 deri në vitin 2015, kam deklaruar çdo vit shtesat në cash bazuar në të ardhurat neto vjetore nga paga dhe interesat bankare, por nuk kam saktësuar pakësimin cash në rastet kur: (I) kam shlyer diferencën e mbetur për apartamentin në Tiranë; (II) kur kam blerë apartamentin në Kavajë; (III) blerjen e bonove të thesarit dhe (IV) shpenzime të tjera nën limitin e kërkuar nga ligji. Kjo mënyrë deklarimi ka ardhur si pasojë e faktit që, gjendja cash e deklaruar ndër vite ka qenë burimi im i vetëm financiar për krijimin e pasurisë që disponoj deri më sot, dhe e kam nënkuptuar që sa herë është bërë blerje apo shpenzim, është pakësuar dhe gjendja cash. Blerja e bonove të thesarit është realizuar nga pakësimi i gjendjes cash të deklaruara vit pas viti, konkretisht në vitin 2010 në shumën 2.000.000 lekë dhe në vitin 2016 në shumën 1.500.000 lekë. Me të njëjtin arsyetim, në vitin 2014, gjendja e kursimeve cash të deklaruara ndër vite, është pakësuar me vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë për blerjen e apartamentit të dytë në Kavajë.

Në deklarimin e vitit 2016 jam përpjekur të pasqyroj në mënyrë korrekte, konform kërkesave të ligjit, transaksionet e realizuara me likuiditetet dhe si përfundim, gjendja ime cash në shtëpi më datë 31.12.2016 është 11.500 USD, ndërsa likuiditetet e tjera janë bono thesari dhe mbetja në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Credins Bank”.

Komisioni, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë, nuk ka konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, Znj. Anila Leka. Deklarimet e saj janë të mjaftueshme, pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

4. Likuiditete të personave të lidhur:

Z. S. L., i ati i subjektit të rivlerësimit:

- Gjendje *cash*, në vlerën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) dollarë dhe 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë. Pjesa takuese 100%. Të ardhurat nga pensioni për periudhën 18.04.2002 - 31.12.2016, në shumën 2.817.418 (dy milionë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

Personi i lidhur, Z. S. L., ka deklaruar si burim për krijimin e likuiditeteve të sipërcituara: *kursimet ndër vite nga pensioni.*

Znj. H. L., e ëma e subjektit të rivlerësimit:

- Gjendja *cash*, me vlerë 9.000 (nëntë mijë) dollarë. Pjesa takuese 100%.

Personi i lidhur, Znj. H. L., ka deklaruar si burim për krijimin e likuiditeteve të sipërcituara: *kursimet ndër vite nga pensioni, si dhe nga dëmshpërblimi i marrë, për ish-të dënuarit politikë në regjimin komunist (si trashëgimtare).*

- Gjendja *cash*, kësti i dytë (kredituar në bankën “Raiffeisen”, datë 10.11.2016, shuma 204.585 lekë dhe tërhequr me datë 24.01.2017)

Nëna e subjektit, Znj. H. L., ka deklaruar si burim për krijimin e likuiditeteve të mësipërme: *nga dëmshpërblimi i ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist (si trashëgimtare).*

- Gjendje *cash* 50.000 lekë, me vlerë 254.585 (dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë. Pjesa takuese 100%.

Nëna e subjektit, Znj. H. L., ka deklaruar si burim për krijimin e likuiditeteve: *kursimet ndër vite nga pensioni.*

Nga analiza financiare e Komisionit rezulton se personat e lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve të deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” dhe ato ndër vite, dhe nuk janë konstatuar elemente të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë. Deklarimet janë të mjaftueshme, pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e pasurisë

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi dhe llogaritë e personave të lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

Nga analiza financiare rezulton se për periudhën 1996 - 2016 subjekti, me të ardhurat e fituara nga pagat⁸ dhe të ardhurat e personave të lidhur,⁹ ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e pasurive të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera.

Sa më sipër, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga

⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, i Prokurorisë së Përgjithshme.

Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës.

⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 13.01.2017, i ISSH-së Tiranë.

Vërtetim nr. *** prot., datë 13.01.2017 i ISSH-së Tiranë.

ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

II. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Anila Leka.*

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Anila Leka, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale).

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk disponon asnjë të dhënë që të mund të ngrejë dyshime të arsyeshme mbi elementin e pastërtisë së figurës për subjektin e rivlerësimit, Znj. Anila Leka.

Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për sa i përket elementit të pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit konstatohet se është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës si prokurore.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Prokurorinë e Përgjithshme (PP) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale, i kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

- Formularin e vetëdeklarimit në 3 (tre) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe te të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 (pesë) dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore, në Prokurorinë e Përgjithshme.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit u bazua në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku u konstatua se:

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Subjekti Anila Leka shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ajo përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur përgjatë arsytimit.

b) Lidhur me aftësitë organizative

Në dokumentet ligjore të përzgjedhura, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Kur subjekti ka pasur rolin e kontrollit të hetimeve, ka evidentuar me hollësi mangësitë e konstatuara në hetimet e kryera. Po kështu, ka lënë detyra të hollësishme në formë orientimesh për hetimet e mëtejshme, fakt që flet për një studim paraprak të thelluar dhe administrimin e çdo të dhëne të rëndësishme në aktet e procedimeve penale përkatëse.

c) Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

Në lidhje me vlerësimin e etikës në punë, subjekti Anila Leka për vitet 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale. Për subjektin Anila Leka nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të saj. Për subjektin Anila Leka, për periudhën objekt vlerësimi, nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional, për subjektin e rivlerësimi nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë. Subjekti Anila Leka, sipas formularit të vetëdeklarimit, rezulton se është angazhuar në një sërë aktiviteteve profesionale të organizuara, qoftë në rolin e pjesëmarrëses qoftë si lektore.

Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale

Për sa më sipër unë, Suela Zhegu, me cilësinë e relatores së çështjes, mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme, si dhe nuk gjeta asnjë indice apo element që

mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores, Znj. Anila Leka, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, propozoj: “E aftë”.

SEANCA DËGJIMORE

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në datën 25.04.2018, trupa gjyquese në prani të përfaqësuesit të vëzhguesve ndërkombëtarë, Z. Hans Kijlstra, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Znj. Anila Leka, në seancë dëgjimore në datën 04.06.2018, ora 14:00, në Pallatin e Kongreseve, në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Znj. Anila Leka është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail*, në datën 25.04.2018, për të cilën edhe ka komunikuar marrjen dijeni dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 04.06.2018, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht. Znj. Leka nuk paraqiti pretendime të reja shtesë, deklaroi se ishte dakord me rezultatet e hetimit dhe kërkoi rikonfirmimin në detyrë.

IV. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të pranueshëm të vlerësimit të aftësive profesionale,

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Znj. Anila Leka, me funksion prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme.

2. Ky vendim, i arsytuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall më datë 06.06.2018, ora 9:00.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

Firdes SHULI
Kryesues

Suela ZHEGU
Relator

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ina SERJANAJ